



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS)

10 / 2022 – zyrtarë

Date: 05.05.2022

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bazë të neni 8 paragrafi 3.2, të rregullores 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, shpall këtë :

THIRRJE PUBLIKE

(Për dy përfaqësuesit nga grupi i Ekspertëve të jashtëm, një nga OJQ dhe një Ekspert për komisionin vlerësues)

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ju njofton se ka bërë hapjen e Thirrjes Publike për subvencionimin e OJQ-ve, të publikuar me datë: 21.04.2022, me titull:

- a. Të gjitha OJQ-të në Komunën e Gjakovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës.
- b. Të gjitha OJQ-të, Klubet Aktive Sportive në Komunën e Gjakovës programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Sportit.

DKRS, fton të gjithë të interesuarit të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues, si ekspert të jashtëm ose përfaqësues të OJQ-ve, që të aplikojnë të jenë pjesë e komisionit.

Kandidatët e interesuar duhen t'i plotësojnë këto kritere, të cilat ndikojnë në përzgjedhje si më poshtë:

1. Përvoja në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike (20 pikë);
2. Përvoja në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbështetje financiare nga burimet publike (10 pikë);
3. Njohja e dokumenteve strategjik dhe politikave prioritare në fushën e thirrjes publike (15 pikë);
4. Njohja e bazës ligjore në fuqi në fushat që mbulon thirrja publike (10 pikë);
5. Njohja e metodologjive ekzistuese brenda fushës së thirrjes publike (20 pikë);
6. Njohja e dokumenteve të tjera relevante në fushën në të cilën është hapur thirrja publike (10 pikë);
7. Njohja e gjuhës së institucioneve kryesore dhe qëllimit të tyre të punës në fushat në të cilat është hapur thirrja publike (15 pikë).

Afati i aplikimit është shtatë ditë pune nga 05.05.2022 deri 16.05.2022.

Kandidatët e interesuar duhet ti plotësojnë këto kritere: Duhet të kenë diplomë universitare; Të kenë përvojë në hartimin e projekteve brenda fushës së thirrjes publike. Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në adresën: Rr. "UÇK" p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës / Zyra e DKRS-së në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi".

Drejtoreshë e DKRS-së



KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Postal address: Nëna Terezë – Gjakovë, Kosovë / 50000 Tel: +381 390 322 591
kk.rks-gov.net/gjakove/